



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**  
**NJESIA E PROKURIMIT**

Nr. 4808/Prot  
5

Shkodër, më 11.03.2025

**KONTRATË SHËRBIMI**  
**Shërbime pritje/përcjellje për delegacione**

E lidhur sot me datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/2025, midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër, e përfaqësuar nga **z. Benet Beci** në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Shkoder i përfaqësuar ne kete kontrate me Vendim Delegimi nr. 755, datë 31.12.2024 nga **z. Onid Bejleri** në cilësinë e Zv/Kryetarit të Bashkisë Shkodër që në vijim do të quhet **Autoriteti Kontraktor**.

**Dhe** Operatorit ekonomik **Persa Lulaj person fizik**, NUIS **L47403002D** regjistruar me regjistrim fillestar me nr. CN-742142-12-14 me adrese: Lagjja "Vasil Shanto", Rruga "At Gjergj Fishta", godine 7-kateshe, kati i I-re, nr. 64, Shkodër përfaqësuar nga **zj. Persa Lulaj**, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar dhe kompetencë të plotë për të përfaqësuar subjektin në të gjitha marrdhëniet që burojnë prej kësaj kontrate me autoritetin Kontraktor, Bashkia Shkodër për realizimin e objektit të kontratës. Në vijim do të quhet "**Kontraktuesi**".

**Neni 1**

**Baza ligjore**

- a. Kodi Civil ligji nr. 7850, datë 29.07.1994, i ndryshuar.
- b. Ligji Nr. 162, dt. 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.
- c. VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.
- d. Ligji nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" i ndryshuar.
- e. Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "Per menaxhimin e aktiveve ne njesite e sektorit publik".

**Neni 2**

**Objekti i kontratës**

- 2.1 Objekt i kësaj kontrate është shërbimi me objekt: "**Shërbime pritje/përcjellje për delegacione**" në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të dhëna në dokumentat e tenderit dhe që **Kontraktuesi - Operatori ekonomik Persa Lulaj person fizik** pranon t'i dorëzojë sipas ofertës së ofruar dhe pranuar si fituese në procedurën e prokurimit.

**Neni 3**

**Vlefte e kontratës**

1

- 3.1 Kontraktuesi merr përsiper të realizojë të gjithë shërbimet tek Autoriteti Kontraktor sipas objektit të lartpërmendur në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të dhëna në dokumentat e tenderit, kundrejt një vlere totale prej **993,600** (nëntëqind e nëntëdhjetetremijë e gjashtëqind ) lekë pa tvsh dhe **1,192,320** (një milion e njëqind e nëntëdhjetetremijë e treqind e njëzet) lekë me tvsh.
- 3.2 Financimi realizohet nga Buxheti i Bashkisë viti 2025.
- 3.3 Çmimet e kontraktorit për shërbimet e kryera sipas kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.

#### **Neni 4**

##### **Afati i kontratës**

- 4.1 Afati i kontratës do të jetë deri me 31.12.2025 duke filluar nga momenti i nënshkrimit të saj nga palët.

#### **Neni 5**

##### **Të drejtat dhe detyrimet e Autoritetit Kontraktor**

- 5.1 Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të përfitojë shërbimin sipas objektit të kontratës.

#### **Neni 6**

##### **Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit**

- 6.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranueshme.
- 6.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.
- 6.3 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoritetit Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështeti dhe ruajë gjithmonë interesin publik.
- 6.4 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në mardhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetencës së tij në përfaqsimin e Autoritetit Kontraktues.

#### **Neni 7**

##### **Detyrimet e Veçanta të Kontraktuesit**

- 7.1 Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha shërbimet siç specifikohet tek Termat e References: Mënyja e ushqimeve për person(drekë/darkë) si më poshtë:
- **Antipastë e personalizuar**

Tortino me patate dhe brokoli e shoqëruar me krem djathi të tymosur ose pulendër krokante me spinak të stufuar në tigan e shoqëruar me krem djathi.

- **Pjatë e parë**

1/2 Linguine me mish patë, purri dhe mente të freskët

1/2 Rizoto me boronicë dhe spek të tymosur ose Çorbe Shkodrane (Supe tradicionale me oriz, mish, erza, veze dhe leng limoni)

- **Pjatë e dytë**

Fileto viçi me piper jeshile dhe salcë demiglas ose mish viç ne saç

Shoqëruese

Patate furrë

- **Embelsirë**

Krem brule me shije vanilie ose musë maskarponeje me krem kafeje dhe biskot krumbëll

- **Pije / person**

0.25 lit. verë të kuqe ose të bardhë

0.5 lit. ujë natyral ose të gazuar

Kafe

*Përgatitja në kuzhine e menysë së mësipërme duhet të bëhet duke përdorur tekniken e gatimit me temperature të ulët duke përdorur këto paisje bazë.*

1. Abatitor ( Sipas normave HACCP)

2. Ronër ( Për gatime më temperaturë të kontrolluar )

3. Makinë vakumi ( Për paketimin hermetik të produkteve në bazë të normativave të HACCP )

7.2 Kontraktuesi duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues të gjitha shërbimet, në sasi të përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë.

7.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.

### **Neni 8**

#### **Lejet dhe Liçensat**

8.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurimin e lejeve ose liçensave sipas kërkesave të Ligjeve të Republikës së Shqipërisë për kryerjen e Shërbimeve në këtë kontratë vec rastit kur palet bien dakord ndryshe.

### **Neni 9**

#### **Afatet e Pagesës**

9.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë çdo pagesë paraprake, duhet të paguhet në kohë siç specifikohet në kontratë.

- 9.2 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit i monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankes së Shqiperise në ditën kur është dërguar njoftimi i kontratës për botim.
- 9.3 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, kërkesa e Kontraktuesit për pagesë duhet t'i bëhet Autoriteti Kontraktues me shkrim. Për çdo kërkesë, Kontraktuesi duhet të paraqesë origjinalin dhe kopjen së bashku me një listë të sendeve që përshkruan shërbimet e kryera për të cilat duhet paguar.
- 9.4 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa për shërbimet do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita që janë kryer Shërbimet, dorëzimi është paraqitur ose arritur, ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë më e vonë.
- 9.5 Data e pagesës do të jete dita që fondet debitoohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktues.
- 9.6 Pagesa për shërbimin e kryer do të bëhet me paraqitjen e dokumentave si më poshte:  
a) Fatures tatimore të Kontraktuesit; (një origjinal)  
b) Procesverbalit të Marrjes në dorëzim të shërbimit
- 9.7 Monedha e pagesës do të jete: LEKE.
- 9.8 Pagesa do të kryhet në llogarinë e Kontraktuesit.

#### **Neni 10**

##### **Vonesa në Bërjen e Pagesës**

- 10.1 Dëmet e llogaritura, të shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë, konsistojnë në kamaten që fillon nga data e vonesës së debitorit (Autoritetit Kontraktues), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti, interesi i maturuar i shtohet shumës totale, mbi të cilën është llogaritur interesi i maturuar.
- 10.2 Kamata ligjore paguhet pa detyruar kreditorin (Kontraktuesin) të provojë ndonjë dëm. Nëse kreditori (Kontraktuesi) provon se ka pësuar një dëm më të madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktues) duhet të paguajë pjesën e mbetur të dëmit.

#### **Neni 11**

##### **Ndryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve**

- 11.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullorë, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

#### **Neni 12**

##### **Forca Madhore**

- 12.1 Kontraktuesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e depozitës së kontrates, dëmet e likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.
- 12.2 Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje e paparashikueshme jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktues qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.
- 12.3 Në se ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoriteti Kontraktues. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktues jep direktiva të ndryshme, Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

### **Neni 13**

#### **Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit**

- 13.1 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, Kontraktuesi duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.
- 13.2 Me përjashtim të rastit kur Autoriteti Kontraktues është dakord për zgjatje të afatit të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të likuidojë dëmet për vonesën në zbatim nëse Kontraktuesi dështon në kryerjen e Shërbimeve brenda periudhës së Kontrates.
- 13.3 Autoriteti Kontraktues mund të zbrësë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj Kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktues duhet t'i japi kontraktuesit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.
- 13.4 Autoriteti Kontraktues do të jetë dakort për një zgjatje të afatit në rastin e Forcës Madhore.
- 13.5 Autoriteti Kontraktues mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të përfundimit të Shërbimeve. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.

### **Neni 14**

#### **Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar**

- 14.1 Dëmet e likuidueshme për kryerjen e vonuar të Shërbimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

- a) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

#### **Neni 15**

##### **Ndërprerja për Mosplotësim**

- 15.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:
- a) Kontraktuesi dështon të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
  - b) Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.
- 15.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi Kontraktuesit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

#### **Neni 16**

##### **Ndërprerja për Shkak të Falimentimit**

- 16.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Kontraktuesi falimenton ose bëhet i paafte të paguajë.
- 16.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

#### **Neni 17**

##### **Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik**

- 17.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.
- 17.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.
- 17.3 Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha Shërbimet e kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Shërbimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesi do të kërkohej të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

#### **Neni 18**

##### **Transferimi i të Drejtave**

- 18.1 Kontraktuesi nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktor.

#### **Neni 19**

##### **Baza Ligjore**

- 19.1 Kontrata do të rregullohet nga dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

#### **Neni 20**

##### **Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

- 20.1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkte.
- 20.2 Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së marrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

#### **Neni 21**

##### **Perfaqesimi i Paleve**

- 21.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.
- a) Personi që do të jenë përgjegjës, administratorët e kontratës në emër të **Autoritetit Kontraktor** për ndjekjen e realizimit të shërbimit dhe përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës do të jenë:
- z. Hasan Mema** me detyrë përgjegjës I Sektorit të Shërbimeve Mbeshtetese pranë Drejtorisë së Burimeve Njerezore dhe Shërbimeve Mbeshtetese  
cel/tel/fax +355673543149  
E-mail: hasan.mema@bashkiashkoder.gov.al
- b) Personi që do të jetë përgjegjës, në emër të Kontraktuesit për administrimin e kontratës dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës është:
- Persa Lulaj  
E-Mail: [gentiluli@hotmail.com](mailto:gentiluli@hotmail.com)  
Telefon: 0692062193
- 21.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.
- 21.3 Palët mund të emërojnë persona ose struktura organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta në të cilin rast njoftimi me shkrim duhet të dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.
- 21.4 Në zbatim të VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", kreu XIII, neni 107, pika 6, "Zbatimi dhe mbikqyerja e kontratës", në përfundim të kontratës, **z. Hasan Mema** si personi që do të jetë përgjegjës, në emër të Autoritetit Kontraktor për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës do të përgatisin një raport përmbljedhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit të kontratës dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti paraqet një informacion për likudimin ose jo të kontratës. Një kopje e këtij raporti i jepet edhe kontraktorit, me kërkesë të tij.

- 21.5 Struktura përgjegjëse duhet të ndjekë me përpikëri ecurinë e zbatimit të kontratës, për t'u siguruar se zbatimi bëhet sipas termave dhe kushteve të kontratës. Personi përgjegjës, në funksion të legjislacionit të prokurimit publik ka/në këto përgjegjësi:
- a) harton e ndjek ecurinë e planit të zbatimit të kontratës;
  - b) kryen monitorimin e zbatimit të detyrimeve të palëve në kontratë, në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë;
  - c) administron dhe verifikon dokumentacionin e dorëzuar nga kontraktori, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
  - ç) sigurohet për kontrollin real e ligjor të kostove, cilësisë dhe afateve, kur është rasti;
  - d) menaxhon dhe trajton problematikat që shfaqen gjatë ekzekutimit të kontratës dhe që nuk sjellin domosdoshmërisht ndryshime/ modifikime/ përshtatje të saj;
  - dh) raporton te titullari i autoritetit/entit kontraktor për shkelje të dispozitave kontraktuale;
  - e) administron kërkesat për ndryshime/ modifikime/përshtatje të zbatimit të kontratës dhe sigurohet që këto kërkesa të kalojnë për miratim në strukturat përkatëse, brenda afateve të përcaktuara në kontratë;
  - ë) mban korrespondencën e përditësuar me të gjitha dokumentet e shkëmbyera me kontraktorin lidhur me zbatimin e kontratës;
  - f) përgatit informacion për çështjet e sipërcituara dhe ia përcjell personit përgjegjës për prokurimin, i cili raporton pranë APP-së

#### **Neni 22**

##### **Hyrja ne fuqi e kontrates**

- 22.1 Kontrata hyn ne fuqi kur plotesohen kushtet e meposhtme:
- a) Mbas nenshkrimit te saj nga te dyja palet.
- 22.2 Kjo kontrate hartohet ne pese kopje origjinale, kater per Autoritetin Kontraktor dhe nje per Kontraktuesin, dhe pasi u lexua, firmoset rregullisht nga palet.

**PËR AUTORITETIN KONTRAKTOR**  
**BASHKIA SHKODËR**

Perfaqesuar me vendim delegimi

**ZV.Kryetar i Bashkisë**

**Onid Bejleri**

**PËR OPERATORIN EKONOMIK**

**Persa Lulaj p.f**

**Persa Lulaj**